



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 3, dt. 08.01.2016

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 08.01.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Paketa e mirëmbajtjes dhe restaurime në Qendrën Historike të qytetit të Beratit, hartuar nga DRKK-Berat:
 - Rindërtimi i murit rrethues së banesës së z. Jovan Prroit, lagjja Goricë, Berat , kod G-039, monument kulture e kategorisë së II (dytë).
 - Restaurimi i strehës së portës së oborrit tek ish shkolla e lagjes "Goricë", sot në pronësi të Greta Kajanës, lagjja Goricë, Berat, kod G-100, monument kulture e kategorisë së II (dytë).
 - Restaurimi i strehës së portës së murit rrethues tek banesa e Lefteri Saveta, lagjes "Goricë", Berat, kod G-117, monument kulture e kategorisë së II (dytë).
 - Restaurimi i murit rrethues së Kishës së Shën Mëhillit, lagjja Mangalem, Berat, kod M-003, monument kulture e kategorisë së I (parë).
 - Restaurimi i Urës së Kasabashit, Corovodë, Skrapar, monument kulture e kategorisë së I (parë).
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI